


	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: "Matrix IM" Sh.p.k. & "X" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë
Nga:	Astrit Mullabazi, U.d. Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	23.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 04.05.2019, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "Matrix IM" Sh.p.k. & "X" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: "Matrix IM" Sh.p.k. & "X" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 16.05.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autorteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “Matrix IM” Sh.p.k. & “X” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me pajisje për zërim**, me Numër të prokurimit: **623-19-1778-1-3-6**, Nr i brendshëm: **623-19-017-1-3-6**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 16.05.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 20.05.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, në cilin pretendon se janë shkelur këto nenet:

- 1 **Neni 1** Qëllimi
- 2 **Neni 6** Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- 3 **Neni 7** Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- 4 **Neni 13** Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
- 5 **Neni 59** Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- 6 **Neni 60** Kriteret për Dhënien e Kontratës
- 7 **Neni 72** Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligji për Prokurimin Publik, dhe nuk janë shkelur asnjë nga këto nenet e lartë përmendura të pretenduara nga Operatori Ekonomik.

A.K. – Komuna e Rahovecit mbështet **Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar**, të dërguar me datë: 16.05.2019, për Grup të Operatorëve Ekonomik: “Matrix IM” Sh.p.k. & “X” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, ku është cekur qartë Arsyen për refuzimin e tenderut tuaj.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër ketij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres se Prokurimit
Komuna e Rahovecit